

## PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE E VNM-së

Në pronën e tij, në fshatin Mbrakull, në Njësinë Administrative Vërtop, zonë në administrim të bashkisë Poliçan, investitori ka filluar ndërmarrjen, nismën e tij, për ndërtimin e një godine grumbullimi, përpunimi dhe shitje e nënprodukteve blegtoriale.




Figure 1 Plani i sistemit të objektit

Kjo nismë u iniciua për faktin që këtë veprimtari, në kushtet e tanishme prej disa vitesh, investitori e zhvillon në ambjente të vogla në dimensione dhe në sasi të reduktuara me një llojshmëri të vogël, të kufizuar për sigurimin e sasive të sipas kërkesave të konsumatorëve, në afërsi të banesës së tij dhe me qëllimin e rritjes së këtij aktiviteti, mori vendimin të fillojë këtë ndërtim.

Investitori, pasi u konsultua më parë me zyrat përkatëse ligjore, kontraktoi me studion e projektimit për realizimin e këtij projekti për përpunimin e nënprodukteve blegtoriale, pasi kjo zonë është e orientuar edhe në drejtimin blegtorial krahas atij bujqësor dhe përpunimin e produkteve blegtoriale janë më shumë në ambjente të vogla dhe jo shumë të përshtatshme përse i përket vendosjes së pasjisjeve të nevojshme për këtë veprimtari.

Grupi i projektimit, në bashkëpunim me përfaqësues të drejtorisë së urbanistikës dhe planifikimit të territorit të njësisë vendore, vizitoi sheshin e ndërtimit dhe konkretisht:

- ☞ pozicionin gjeografik dhe përputhjen me hartën e pronësisë,
- ☞ gjendjen e përdorimit të tokës vitet e fundit,
- ☞ kufizimet anësore,
- ☞ gjendjen e kanalizimeve,

- ☞ mundësinë e ndërtimit të këtij objekti dhe pozicionimin sipas dimensioneve të kërkuara në lidhje me kufizimet e sipërfaqes së sheshit të ndërtimit,
- ☞ mundësinë për ngritjen e infrastrukturës së re përsa i përket furnizimit me ujë, me energji elektrike pasi sheshi i ndërtimit është i lidhur me rrugën e brendshme të kësaj zone dhe ska nevojë për ndërtim të ri,
- ☞ pozicionin në lidhje me banesat private ose publike,
- ☞ kushtet gjeologjike, atmosferike dhe sizmike,
- ☞ konsiderimin e produktivitetit të aktivitetit,
- ☞ gjykimin në tërësi të studimit të fizibilitetit të veprimtarisë.



Figure 2 Koordinatat e sheshit të objektit

Nr	Lindje	Veri
1	4421268.76	4499856.12
2	4421319.95	4499801.63
3	4421276.74	4499757.31
4	4421233.22	4499808.91

Pas këtyre konstatimeve fizike në terren, grupi i projektimit konstatoi në tërësi:

- ▶ kërkesa për ndërtimin e këtij objekti është në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe planin urbanistik të zonës.
- ▶ nga fondi tokës bujqësore preket vetëm një pjesë e vogël e saj dhe në tërësi nuk ka ndikim negativ sepse kjo sipërfaqe nuk ka patur ndonjë prodhimtari bujqësore apo blegtorale të konsiderueshme në përputhje me shtritjen e saj.
- ▶ ka kushte të favorshme dhe në zbatim të rregullave dhe ligjeve në fuqi për marrjen e ujit me pus që do hapet nga investitori sipas lejes që do marrë më parë. Duke konsideruar këtë veprimtari nuk kemi pakësim të ujrave nëntokësore pasi nevojat janë në sasi të vogla për përpunimin e nënprodukteve blegtoriale.
- ▶ ka kushte të favorshme dhe në zbatim të rregullave dhe ligjeve në fuqi për furnizimin me energji elektrike nga kabina që do ndërtohet sipas lejes që do jepet më parë nga ana veriore e objektit që do ndërtohet.
- ▶ nuk ka afër banesa apo objekte të tjera publike që mund të ndikohen nga zhvillimi i kësaj veprimtarie.

- ▶ që në fillim të vendim marrjes për ndërtimin e këtij objekti, kanë qenë të pranishëm dhe ekspertë të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të cilët kanë dhënë konsideratat e tyre në çdo moment të zhvillimit të projektit.

Nga sa më sipër, u vendos që të pregatitet dokumentacioni i duhur tekniko-ligjor për ndërtimin e këtij objekti dhe zhvillimin më pas të veprimtarisë së përpunimit të nënprodukteve blegtoriale me qëllim tregtimin për konsumim dhe do të pregatitej dhe raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis, më poshtë VNM.




Figure 3 Sheshi sipas Planit të Përgjithshëm Vendor

Sipas planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Polican, Planit të Zhvillimit të Territorit miratuar me vendimin e KKT-së Nr. 4, datë 08.02.2017, sheshi i objektit të kërkuar për ndërtimin e kësaj veprimtarie, ndodhet në një zonë bujqesore por të miratuar për ndërtime deri në dy kate duke shtuar dhe çati, në një lartësi deri në 7 m dhe 1.2 m çatia.

Objekti i kërkuar është brenda këtyre normave sepse është një kat mbi tokë dhe nuk e kalon lartësinë sipas planifikimit.

Raporti i VNM-së që në fillim të shqyrtimit për hartimin e tij, ka synuar të sigurojë masa për mbrojtje të lartë të mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm, përmes përfshirjes së çështjeve të mjedisit gjatë hartimit të projektit të ndërtimit të këtij objekti. Pavarësisht këtij koordinimi mes specialistëve të projektimit dhe analizave mjedisore, disa nga punimet e ndërtimit, kanë mundësi të shkaktojnë pasoja negative në mjedis, për shkak të natyrës dhe të nivelit ekzistues të teknologjisë që do përdoret dhe përdoret shpesh në ndërtim.

Për të shmangur apo minimizuar këto pasoja, VNM-ja propozon masat përkatëse dhe një plan hapash për zbatim që do trajtohen në këtë material.

Në raportin e VNM-së janë analizuar të gjithë përbërësit mjedisorë dhe janë marrë parasysh të gjitha ndikimet e mundshme, që punimet për ndërtim dhe më pas për shfrytëzim, mund të kenë në mjedis.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar dhënies së rekomandimeve dhe masave për parandalimin apo zbutjen e ndikimeve të mundshme në mjedis në të dy etapat, gjatë ndërtimit dhe gjatë shfrytëzimit.

## 2.–Përshkrimi i qëllimit dhe objektivave.

Qëllimi kryesor i hartimit të raportit të VNM-së është reflektimi i drejtëpërdrejtë i qëllimit të ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, sigurimin e një niveli të

lartë të mbrojtjes së mjedisit, evidentimi dhe identifikimi i ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe marrja e masave të domosdoshme për minimizimin dhe parandalimin e efekteve të dëmshme në mjedis gjatë ndërtimit të këtij objekti dhe më pas gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti.

Qëllimi i hartimit të raportit të VNM-së është të identifikojë mënyrat se si projekti i propozuar mund të hartohet dhe të transformohet në mënyrë të tillë për të zbutur efektet e padëshiruara në mjedis. Në mënyrë të thjeshtë, zbutja e mjedisit është konsideruar të përfshijë ndonjë veti të projektit të propozuar, i cili shmang, zvogëlon ose riparon efektin e saj negativ mbi mjedisin apo siguron përfitime mjedisore.

Masat zbutëse mund të përfshijnë aspektet fizike të projektit apo mënyrat sipas të cilave ai është projektuar dhe do të ndërtohet.

Në përmbushje të detyrimeve të legjislacionit shqiptar me qëllim që të sigurohet:

- një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekti i propozuar që përpara miratimit të tij për zhvillim;
- garantimi i një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimit të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur; si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të duke synuar të përcaktojmë kërkesat, përgjegjësitë, rregullat dhe procedurat për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedis nga implementimi i projektit të propozuar.

Projekti ynë që kërkohet “*Ndërtim godine grumbullimi, përpunimi dhe shitje e nënprodukteve blegtoriale*”, në fshatin Mbrakull, në Njësinë Administrative Vërtoq, zonë në administrim të bashkisë Poliçan, në një distance prej 20 km nga dalja e qytetit të Beratit, klasifikohet në projektet të parashikuar në ligjin nr. 10440, datë 07.07.2011, “*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*”, të ndryshuar, projektet e Shtojcës II, pika 7. *Industria ushqimore, shkronja, b) Prodhimi, përpunimi dhe paketimi i produkteve shtazore dhe bimore*, si rrjedhim i nënshtrohen **procedurës paraprake të vlerësimit të ndikimit në mjedis**.

Pas ndërtimit në referim të ligjit nr.10448, datë 14.07.2011, “*Për lejet mjedisore*”, i ndryshuar, do të vijojë dokumentacionin për transferim leje mjedisore të tipit C që disponon, LC 9412-12-2014, me nr. 472 prot, datë 19.12.2014, nëse nuk ka rritje të kapacitetit mbi 2ton/ditë, sipas klasifikimit të tabelës të veprimtarive, *Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to, ID 7.7, e), Trajtimi dhe përpunimi i qumështit, Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 2 tonë/ditë ose më pak*, duke konsideruar që kapaciteti i projektuar dhe gjatë shfrytëzimit do jetë shumë më i vogël se kjo sasi e parashikuar nga ligji dhe duke ju referuar zhvillimeve të tanishme në sasinë prej rreth 12 kv/ditë.

Projekti ynë ka të bëjë me aktivitet ndërtimi të një godine për grumbullimin, përpunimin dhe shitje e nënprodukteve blegtoriale, në një territor të pashfrytëzuar deri tani për ndonjë qëllim të vecantë në anën bujqësore apo blegtoriale për shkaqe që trajtuam më sipër.

Planet e negociatave me organet e pushtetit vendor, publikun e gjerë, etj. janë menduar si tepër të nevojshme që momentin e projekt idesë për këtë sipërmarrje ndërtimi dhe krahas bisedimeve me banorët janë konsultuar në mënyrë të vazhdueshme dhe ligjore edhe me organet e pushtetit vendor.




Figure 4 Sheshi sipas Ndarjes Administrative

Sipas këtyre konsultimeve dhe bazës ligjore në të cilën mbështetet ky raport, del që kërkesa për këtë zhvillim të ri objekti, është në përputhje të plotë me planet vendore të miratuara më parë si c edhe është e publikuar në faqet zyrtare shtetërore.

Nuk ka patur asnjë opion për një vendndodhje tjetër të projektit, as për qellime jashtë këtij përfundimtar dhe gjatë fazave të ndërtimit nuk do të përdoren burime natyrore apo minerare.

Ndikimet mjedisore do të jenë të lidhura si me fazën e ndërtimit (parashikohet që këto ndikime të jenë për një kohë të shkurtër duke konsideruar kohën e shkurtër të ndërtimit) dhe gjatë fazës së shfrytëzimit të cilat do jenë për gjatë gjithë kohës së veprimtarisë.

Projekti do të sjellë një përmirësim të pergjithshem të cilësisë mjedisore në lidhje me uljen e sipërfaqes së tokës të pashfrytëzueshme, në rritjen e sipërfaqeve të gjelbërimit, në përmirësim të anës social-ekonomike dhe përmirësim të furnizimit të konsumatorëve me nënprodukte blegtoriale të pregatitur në kushte të mira teknike dhe higjieno sanitare.

Ndikimi potencial mjedisor në fazën e ndërtimit, do të jetë minimal dhe i lehtë për tu identifikuar, analizuar dhe për të marre masa zbutëse ndaj këtij ndikimi në mjedis dhe sipas arsytimit të mësipërm, në këtë raport bëhet fjaë për një vlerësim "përmbledhës" të ndikimit mjedisor për ndërtimin e këtij objekti.

Ndërsa në fazën e hyrjes në shfrytëzim dhe gjatë kohës së shfrytëzimit do kërkohet zbatimi me rigorozitet të plotë i kushteve të lejes mjedisore dhe në monitorim të vazhdueshëm nga investitori sipas detyrimeve që rrjedhin nga kushtet e lejes mjedisore që praktikisht investitori e ka për këtë aktivitet.

Qëllimi në mënyrë finale është të identifikojë dhe të sigurojë informacion të duhur për investitorin, për subjektin ndërtues, për publikun dhe institucionet e tjera për pasojat mjedisore të ndërtimit të këtij objekti, duke filluar nga piketimi i sheshit të ndërtimit deri në përfundim të plotë të punimeve si dhe të trajtojë periudhën e shfrytëzimit në detaje të përmledhura sepse të detajuara janë ato të lejes mjedisore të shfrytëzimit.

Brenda këtij qëllimi në hartimin e kësaj VNM-je kemi konsideruar:

- › alternativat për vendndodhjen dhe ndikimet mjedisore shoqëruese;
- › përmirësimin e plani mjedisor;
- › përdorimin si duhet dhe në mënyrë eficiente të burimeve;
- › masat e duhura për zbutjen e ndikimeve të mundshme të propozimit të këtij projekti;
- › kushtet për ndërtimin duke synuar që të realizohet në një kohë sa më të shpejtë.

Objektivi i këtij raporti është vlerësimi në mënyrën e duhur të efekteve të drejtpërdrejta dhe indirekte të këtij projekti sipas klasifikimit:

- Efektet në njerëz pranë dhe afër këtij objekti që kërkohet;
- Ndikimet në tokë, ujë, klimë dhe peisazh të zonës;
- Ndikimet në materiale dhe asete kulturore;
- Ndërveprimet midis këtyre faktorëve që përmendëm.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis synon parimin e parandalimit duke miratuar variantin më të mirë, që në fazën e fillimit të vendimmarrjes dhe hartimit të projektit, për të shmangur ndikime të dëmshme të kësaj veprimtarie në mjedis.

Për këtë çështje të menaxhimit të mbeturinave, kjo lloj hierarkie aktualizohet në tre nivele:

1. parandalim;
2. rikuperim;
3. shpërbërje.

Parimi i parandalimit dhe parimi i masave paraprake vendos detyrën të zvogëlojë emetimin ndotës në burim pavarësisht nga kostatimi efektiv i një efekti mjedisor negativ pra dhe në mungesë të provave që tregojnë ekzistencën e një lidhjeje rastësore midis emetimeve dhe efekteve negative.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis ka si objektiv të përcaktojë:

- Përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta të mjedisit gjatë ndërtimit dhe funksionimit të këtij objekti.
- Ndikimet mjedisore në lidhje me gjendjen e mjedisit ku kërkohet të ndërtohet ky objekt për montimin dhe zhvillimin e këtij aktiviteti.
- Propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen dhe minimizimin e ndikimeve negative dhe rritjen e ndikimeve pozitive në mjedis.

Gjatë procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis kryhen identifikimi, përshkrimi dhe vlerësimi, në mënyrën e duhur, i ndikimit në mjedis të kësaj veprimtarie duke përcaktuar efektet e mundshme, të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta mbi tokën, ujin, ajrin, pyjet, klimën, shëndetin e njeriut, florën dhe faunën, peizazhin natyror, pasuritë materiale e trashëgiminë kulturore, duke pasur parasysh lidhjet e tyre të ndërsjella.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis zbaton parimin e parandalimit që në fazën e hershme të planifikimit të projektit, me qëllim shmangien apo minimizimin e efekteve negative në mjedis, nëpërmjet harmonizimit dhe përshtatjes së saj me kapacitetin bartës të mjedisit.

VNM-ja mendohet si një mënyrë për të ndaluar projekte që kanë ndikime të papranueshme në mjedis, por një pikëpamje shumë më pozitive dhe e dobishme është të mendohet për VNM-në si një mënyrë për të ndihmuar zhvilluesit dhe vendimmarrësit të projektojnë projekte që të kenë ndikim sa më të vogël të mundshëm në mjedis, në mënyrë që ata të mund të lejohen të shkojnë përpara dhe të sigurojnë përfitime të tjera që zhvillimi krijon për ekonominë dhe shoqërinë. VNM-ja bën këtë duke identifikuar ndikimet mjedisore dhe zbutjen e tyre gjatë studimeve vlerësuese.

Ekipi i VNM-së ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme që në faza të hershme të marrjes së detyrës së projektimit me ekipin e projektimit dhe do bashkepunojë me zhvilluesin e këtij projekti ndërtimi gjatë gjithë zhvillimit të projektit për të identifikuar mënyrat nëpërmjet të cilave ato mund të reduktohen dhe që janë parashikuar më parë. Ky është një proces i vazhdueshëm deri në përfundim të objektit. Bashkëpunimi është realizuar për të vendosur se çfarë është e mundur dhe e përballueshme në kontekstin e zhvillimit të propozuar duke miratuar dhe projektuar variantin më të mirë me sa me pak ndikime në mjedis.

Raporti i VNM-së përshkruan në vijim të gjitha masat që zhvilluesi është përgatitur të adoptojë dhe ndikimet mbetëse pas zbutjes. Masat zbutëse janë paraqitur si angazhime në mënyrë që autoriteti kompetent të dijë se çfarë mund të marrë parasysh në marrjen e vendimit nëse do të japë pëlqimin. Parashikimi i ndikimit të ngjarjeve të pazakonshme në VNM-në merret kryesisht me pasiguritë që lidhen me ndikimet që janë relativisht të sigurt që të ndodhin - ato janë pasojat e operacioneve rutinë të projektit. Megjithatë, gjithmonë qëndron një rrezik që një ngjarje e pazakonshme mund të shkaktojë probleme të rënda mjedisore gjatë ciklit të jetës së një projekti.

Objektivat kryesore të kësaj procedure për vlerësimin e ndikimit mjedisor mund të përmblihen si më poshtë:

- Sigurimin e plotë që konsideratat mjedisore janë të trajtuara shprehimisht dhe janë të përfshira në procesin e vendimmarrjes;
- Përshkrimin mbi mënyrën se si projekti ndikon në kushtet aktuale mjedisore;
- Është marrë parasysh shmangia, reduktimi dhe minimizimi i ndikimeve potenciale në mjedis edhe aspektet socialo-ekonomike si edhe ato të shëndetit të njeriut;
- Janë dhënë sugjerime në lidhje me masat që duhet të përfshihen në projekt për të reduktuar apo neutralizuar ndikimet negative mjedisore si dhe për të reflektuar ndryshime të tjera të paparashikuara;
- Përcaktimin e një programi të përshtatshëm monitorimi për të verifikuar që të zbatohen me efektivitet dhe sukses të plotë masat e nevojshme për mbrojtjen e mjedisit.
- Identifikimi dhe analiza e ndikimeve të projektit të propozuar në mjedisin natyror.
- Vlerësimi i ndikimeve të projektit në mjedisin social-kulturor të zonës dhe në tërësi.
- Vlerësimi i ndikimeve në infrastrukturë dhe lehtësira sociale (kanalizimi, furnizimi me ujë, rrjeti rrugor, energjia elektrike.)
- Vlerësimi dhe parashikimi i ndonjë efekti në ndonjë ekosistem të ndjeshëm të zonës.
- Identifikimi dhe parashikimi i ndikimeve dhe ndryshimet në politikën e zhvillimit në lidhje me zonën.
- Formulimi i një Plani të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS).

Me qëllim plotësimin e këtyre objektivave sipas referencave të përmenduar më sipër ky raport VNM-je është strukturuar në mënyrë të mëposhtme:

- a) Të dhëna mbi zonën aktuale të mjedisit dhe zonat përreth ku zbatohet projekti;
- b) Objektivat e projektit;
- c) Përshkrim i detajuar i të gjitha instalimeve që janë pjesë e projektit apo që do përdoren gjatë zbatimit të tij;
- d) Plani i ndërtimit dhe afatet për zbatimin e tij;
- e) Përshkrimi i vlerave inxhinierike që do të ndërtohen si edhe përshkrimi i punimeve të nevojshme për zbatimin e projektit;
- f) Ndikimet potenciale në mjedis dhe masat e propozuara për të parandaluar apo për të amortizuar këto ndikime;
- g) Program monitorimi të ndikimeve të projektit në mjedis;
- h) Masa rehabilituese në rast ndotjeje apo/dhe dëmtimi të mjedisit, si edhe kostot përkatëse;
- i) Përputhshmeria e projektit me planet e rregullimit të territorit dhe me planin e zhvillimit ekonomik të zonës ku do të zbatohet projekti;
- j) Përmbledhje e konsultimeve me organet e pushtetit vendor, me publikun e gjerë dhe organizatat jo-fitimprurëse, si edhe mendimeve të tyre.

Këto përcaktohen si kërkesa të përgjithshme dhe të jenë pjesë e një raporti në hartimin e një VNM-je, në zbatim të ligjit nr.10440, datë 07.07.2011, "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis" të ndryshuar si dhe akteve të tjera ligjore të referuara në vijim të këtij raporti.